

KËRKESAT PËR SHPËRBLIM TË DREJTË¹

I. Hyrje

1. Akordimi i shpërblimit të drejtë nuk është pasojë automatike e konstatimit prej Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut të shkeljes së një të drejte të garantuar sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokolleve të saj. Kjo është e qartë nga formulimi i Nenit 41 që parashikon se Gjykata akordon shpërblim të drejtë vetëm nëse e drejta e brendshme nuk lejon që të realizohet riparimi i plotë, madje edhe në raste të tilla, vetëm “nëse është e nevojshme” (s’il y a lieu në tekstin frengjisht).

2. Për më tepër, Gjykata do të akordojë shpërblim që vlerësohet “i drejtë” (équitable në tekstin frengjisht) sipas rrethanave të caktuara. Rrjedhimisht, do të merren parasysh veçoritë e secilës çështje. Gjykata mund të konsiderojë që konstatimi i shkeljes përbën shpërblim të drejtë në vetvete dhe nuk është e nevojshme të akordojë shpërblim financiar. Ajo mund ta vlerësojë të drejtë akordimin e një shume më të vogël se vlera e dëmit të pësuar realisht ose të shpenzimeve të kryera realisht, apo madje edhe të mos akordojë asnjë shpërblim. Ky mund të jetë rasti, për shembull, nëse ankuesi është fajtor për situatën për të cilën ankohet apo për vlerën e kompensimit të dëmit ose nivelit të shpenzimeve. Në caktimin e vlerës së shpërblimit, Gjykata mund të marrë parasysh pozitën përkatëse të ankuesit si palë e dëmtuar, dhe të Palës Kontraktuese si përgjegjëse për interesin publik. Së fundi, Gjykata normalisht do të marrë parasysh rrethanat ekonomike të vendit.

3. Kur akordon shpërblim sipas Nenit 41, Gjykata mund të vendosë që të marrë parasysh standartet vendase. Gjithsesi, këto standarte nuk janë detyruese për Gjykatën.

4. Ankuesit paralajmërohen që respektimi i kushteve formale dhe materiale të vendosura sipas Konventës dhe Rregullores së Gjykatës është një kusht për akordimin e një shpërblimi të drejtë.

II. Parashtrimi i pretendimeve për shpërblim të drejtë: kushtet formale

5. Afatet dhe kushtet e tjera formale për parashtrimin e pretendimeve për shpërblim të drejtë janë të përcaktuara në Nenin 60 të Rregullores së Gjykatës, pjesa përkatëse e të cilës lexon si më poshtë:

“1. Ankuesi që dëshiron të përfitojë shpërblim të drejtë sipas Nenit 41 të Konventës në rast se Gjykata gjen shkelje të të drejtave sipas Konventës, duhet të bëjë kërkesë të qartë për atë qëllim.

2. Ankuesi duhet të paraqesë të gjitha pretendimet e tij, të shifruara dhe të ndara sipas zërave financiare, së bashku me të gjitha dokumentet mbështetëse përkatëse brenda afatit të caktuar për parashtrimin e komenteve të tij mbi themelin e çështjes, përveç rasteve kur Kryetari i Dhomës vendos ndryshe.

3. Nëse ankuesi nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në paragrafet e mësipërme, Dhoma mund të refuzojë pretendimet në tërësi ose pjesërisht.

(...)”

Në këtë mënyrë, Gjykata kërkon që të bëhen pretendime të qarta, të mbështetura me provat e duhura dokumentuese, pa të cilat ajo nuk mund të akordojë shpërblim të drejtë. Gjykata po ashtu do të refuzojë pretendimet e paraqitura në formularin e ankimit të cilat nuk janë riparuar në fazën e duhur të procedurës, si dhe pretendimet e paraqitura jashtë afatit.

¹ Udhëzime praktike miratuar nga Kryetari i Gjykatës në përputhje me Nenin 32 të Rregullores së Gjykatës më 28 Mars 2007.

III. Parashtrimi i pretendimeve për shpërblim të drejtë: kriteret materiale

6. Shpërblimi i drejtë mund të akordohet në bazë të Nenit 41 të Konventës për:

- (a) dëmin material;
- (b) dëmin moral; dhe
- (c) shpenzimet.

1. Dëmi

7. Duhet të konstatohet një lidhje shkakësore e qartë mes dëmit të pretenduar dhe shkeljes së pretenduar. Gjykata nuk do të mjaftohet nga një lidhje e thjeshtë mes shkeljes së pretenduar dhe dëmit, dhe as nga spekulimi i thjeshtë se çfarë mund të kishte ndodhur.

8. Shpërblimi për dëmin mund të akordohet nëse dëmi është rezultat i shkeljes së konstatuar. Nuk mund të akordohet shpërblim për dëmin e shkaktuar nga ngjarjet dhe situatat për të cilat Gjykata nuk ka konstatuar shkelje të Konventës ose për dëmin lidhur me ankimet e shpallura të papranueshme në një fazë të mëparshme të procedurës.

9. Qëllimi i akordimit të shpërblimit nga Gjykata përsa i përket dëmit është që të kompensojë ankuesin për pasojat e dëmshme dhe reale të shkeljes. Gjykata nuk ka për qëllim të ndëshkojë Palën Kontraktuese përgjegjëse. Si pasojë, Gjykata deri tani e ka vlerësuar të pavend pranimin e pretendimeve për shpërblim me emërtime si “ndëshkuese”, “rënduese” ose “si mësim”.

2. Dëmi material

10. Përsa i përket dëmit material, parimi është që ankuesi të vihet, për aq sa është e mundur, në pozitën në të cilën ai ose ajo do të kishin qenë sikur shkelja e konstatuar të mos kishte ndodhur, me fjalë tjera, *restitutio in integrum*. Kjo mund të përfshijë kompensim si për humbjen e vërtetë të pësuar (*damnum emergens*) ashtu dhe për humbjen, ose fitimin e munguar që pritet të ndodhë në të ardhmen (*lucrum cessans*).

11. I takon ankuesit të tregojë se dëmi material ka rezultuar nga shkelja ose shkeljet e pretenduara. Ankuesi duhet të dorëzojë dokumente përkatëse për të dëshmuar, për aq sa është e mundur, jo vetëm ekzistencën e dëmit por edhe shumën ose vlerën e tij.

12. Normalisht akordimi nga Gjykata do të reflektojë shumën e plotë të përlllogaritur të dëmit. Megjithatë, nëse dëmi i vërtetë nuk mund të llogaritet në mënyrë të saktë, Gjykata do të bëjë përlllogaritje bazuar në faktet e disponueshme. Siç është theksuar në paragrafin § 2 më lart, është gjithashtu e mundur që Gjykata të çmojë si të drejtë akordimin e një shume më të vogël se shuma e plotë e pretenduar.

3. Dëmi moral

13. Akordimi i shpërblimit nga Gjykata lidhur me dëmin moral ka për qëllim të ofrojë kompensimin financiar për dëmin moral, për shembull për dhimbjen shpirtërore ose fizike.

14. Për nga natyra, dëmi moral nuk mund t'i nënshtrohet përlllogaritjes së saktë. Nëse konstatohet ekzistenca e një dëmi të tillë, dhe nëse Gjykata konsideron se shpërblimi monetar është i nevojshëm, ajo do të bëjë një vlerësim në baza të drejta, duke marrë parasysh standartet që dalin nga praktika e saj gjyqësore.

15. Ankuesit që dëshirojnë të kompensohen për dëmin moral ftohen të qartësojnë shumën e cila sipas pikëpamjes së tyre do të ishte e drejtë. Ankuesit që e konsiderojnë veten viktimë të më shumë se një shkelje mund të kërkojnë një shumë të përbashkët që mbulon të gjitha shkeljet e pretenduara ose shuma të veçanta për secilën shkelje të pretenduar.

4. Kostot dhe shpenzimet

16. Gjykata mund të urdhërojë që ankuesit t'i rimbursohen shpenzimet që i janë shkaktuar – së pari në nivel të brendshëm, dhe rrjedhimisht , në procedurën përpara vetë Gjykatës – në përpjekje për të parandaluar shkeljen ose në përpjekje për të siguruar korrigjimin e saj. Shpenzime të tilla të procedurës zakonisht përfshijnë koston e ndihmës juridike, tarifat gjyqësore të regjistrimit dhe shpenzime të tjera të ngjashme. Aty mund të përfshihen edhe shpenzime të udhëtimit dhe të jetesës, sidomos nëse shpenzime të tilla janë shkaktuar nga pjesëmarrja në një seancë dëgjimore përpara Gjykatës.

17. Gjykata do të pranojë kërkesat vetëm për ato shpenzime të cilat kanë lidhje me shkeljet e konstatuara. Gjykata do të refuzojë ato shpenzime që kanë të bëjnë me ankesa për të cilat nuk janë konstatuar shkelje ose me ankesa të shpallura të papranueshme. Prandaj, do të ishte më mirë që ankuesit të parashtrojnë shpenzime të veçanta për ankesa të veçanta.

18. Shpenzimet duhet të kenë ndodhur në të vërtetë. Pra, ankuesit duhet t'i kenë paguar ato ose kanë qenë të detyruar t'i paguajnë ato, në bazë të një detyrimi ligjor ose kontraktual. Çdo shumë që është paguar ose do të paguhet nga autoritetet vendase ose nga Këshilli i Evropës, në kuadër të ndihmës ligjore, do të zbritet.

19. Shpenzimet duhet të kenë qenë të nevojshme. Pra, ato duhet të kenë qenë të pashmangshme për të parandaluar shkeljen ose për ta korrigjuar atë.

20. Ato duhet të jenë të arsyeshme përse i përket shifrimit. Nëse Gjykata çmon se ato janë të tepruara, ajo do të akordojë një shumë që në përlllogaritjen e saj është e arsyeshme.

21. Gjykata kërkon prova, si fletëpagesa dhe fatura të sakta. Ato duhet të jenë të detajuara në mënyrë të mjaftueshme që të mundësojnë Gjykatën të vërtetojë se në çfarë mase janë plotësuar kushtet e sipër përmendura.

5. Të dhënat mbi pagesën

22. Ankuesit ftohen të japin një llogari bankare në të cilën ata dëshirojnë që t'u paguhet shumat e akorduara. Nëse ankuesit dëshirojnë që shumat të caktuara, për shembull shumat e akorduar për shpenzimet e procedurës, të paguhet veçmas, për shembull drejtpërdrejt në llogarinë bankare të përfaqësuesit të tyre, ata duhet ta qartësojnë këtë fakt.

IV. Forma e akordimit të shpërblimit nga Gjykata

23. Shpërblimet e akorduara nga Gjykata, nëse do të ketë, zakonisht do të jenë në formën e shumës së parave që Pala Kontraktuese do t'i paguajë viktimës ose viktimave të shkeljeve të konstatuara. Vetëm në raste tepër të rralla, Gjykata mund të ftojë Palën Kontraktuese të marrë masa të caktuara me qëllim dhënien fund ose korrigjimin e shkeljes në fjalë. Sidoqoftë, Gjykata mund të vendosë, në përputhje me ushtrimin e diskrecionit të saj, të japë udhëzime për zbatimin e vendimit (Neni 46 i Konventës).

24. Çdo shpërblim monetar sipas Nenit 41 zakonisht do të bëhet në euro (EUR, €), pavarësisht valutës në të cilën ankuesi shpreh pretendimet e tij/saj. Nëse ankuesi do të marrë pagesën në valutë tjetër, Gjykata do të urdhërojë që shumat e akorduara të konvertohen në atë valutë sipas kursit të këmbimit që është i zbatueshëm në datën e pagesës. Kur paraqesin pretendimet e tyre, ankuesit duhet të kenë parasysh, sipas rastit, rrjedhojat e kësaj politike në dritën e efekteve të konvertimit të shumave të shprehura nga valutat e tjera në euro ose anasjelltas.

25. Gjykata kryesisht cakton një afat për pagesat që duhet të bëhen; zakonisht, ky afat është tre muaj, duke filluar nga data kur vendimi bëhet përfundimtar dhe detyruar. Gjykata po ashtu urdhëron të paguhet kamatë-vonesë në rast se pagesa kryhet përtej afatit tre-mujor; kamatë-vonesa zakonisht llogaritet si një normë e thjeshtë interesi e barabartë me shkallën margjinale të kreditimit

(huadhënies) të Bankës Qendrore Evropiane, për periudhën që ka filluar nga skadimi i afatit tre mujor deri në kryerjen e pagesës, duke e rritur me tre pikë përqindje.